



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:075051

Datë: 26.04.2019

Numri i dokumentit: 00292693

P.nr.140/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Berna Maliqi, në çështjen penale kundër të pandehurit S. R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri të paraqitur nga ana Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.38/2019, të datës 06.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 17.04.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri S. R., nga babai dhe nena, e lindur, i lindur me datë, në fshatin, me vendbanim në Gjilan, rr.”.....” pa numër, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse në gjysmën e dytë të muajit dhjetor 2018, në Gjilan, në shtëpinë e përbashkët familjare, i pandehuri në gjende të pallogaritshme mendore, me qëllim të shkakimit të dhëmbjes, mundimit, frikës, përljes dhe shqetësimit të bashkëshortes së tij-viktimës së ndjeshme E. R., ka shkaktuar dhunë në familje, duke e sulmuar fizikisht të njëjtën pa pëlqimin e saj dhe në kundërshtim me nenin 2, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.4 të Ligjit për Dhunë në Familje, në atë mënyrë që pas një debati rreth qëndrimit në shtëpi dhe një inati të mëhershëm, përderisa ishin me qëra, i pandehuri i kërkon të largohet nga shtëpia dhe bëhet agresiv, me çrast e godet disa herë me grushte në kokë dhe shqelma në barkë, më pas e kap një karrige me të cilën tenton ta sulmoj por ia ka e dëmtuara me çrast e lëndon gishtin e tretë të dorës së djathtë, mirëpo ndërhyrjen fëmijët e tyre dhe e pengojnë që ta rrah më tepër dhe në këtë mënyrë tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, dhimbje, mundim dhe shqetësim të madh emocional.

-Me çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 87,88,89, dhe 90 të KPRK-së, si dhe nenit 514 paragrafi 3 të KPP-ës, i shqipton:

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUSHËM PSIKIATRIK NË LIRI NË INSTITUCIONIN SHËNDETËSOR

- I. Ashtu që ndaj të pandehurit S. R. i shqiptohet masa e trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, por e cila masë nuk do të ekzekutohet sepse me aktvendimin e kësaj gjykate P.nr.101/19, të datës 04.02.2019, të njejtimit tanimë i është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri dhe ai gjindet në trajtim në Qendrën e Shëndetit Mental në Gjilan dhe se shqiptimi i të njejtës masë nuk do të ishte në interesin më të mirë të tij dhe nuk do të kishte ndonjë efekt dhe natyrisht se nuk do t i shërbente ndonjë qëllimi.
- II. Obligohet i pandehuri S. R. që të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mental në Gjilan, në mënyrë që t'i nënshtrohet trajtimit psikiatrik sipas aktvendimi të kësaj gjykate me numër P.nr.101/19, të datës 04.02.2019 dhe t'u nënshtrohet rregullave të caktuara nga mjeku përkatës.
- III. Qendrën e Shëndetit Mental në Gjilan, ËSHTË E OBLIGUAR që së paku 1 (një) herë në 6 (gjashtë) muaj ta njoftojë këtë gjykatë lidhur me gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit të lartpërmendur.
- IV. Në rast se i pandehuri S. R., nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të institucionit të kujdesit shëndetësor do ta zëvendësojë këtë masë me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim.
- V. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 06.02.2019, ka paraqitur propozimin për shqiptimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri me numër PP.II.nr.38/19, kundër të pandehurit S. R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Me datë 17.04.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit, e dëmtuara E. R., i pandehuri S. R., mbrojtësja e të pandehurit e caktuar sipas detyrës zyrtare avokatja Zanita Leka-Qerimi si dhe eksperti psikiatër Dr.Afrim Cana. Në këtë seancë eksperti psikiatër Dr.Afrim Canaj, i ftuar nga ana e gjykatë që të deklarohej lidhur me gjendjen mendore të të pandehurit, ka shtuar se në rastin konkret fjala është për një person i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të përkeqësimit psikik dhe veprimet e tij kanë qenë direkt të ndikuar nga gjendja e tij mendore, po ashtu i njejt ka njoftuar gjykatën se i pandehuri tanimë gjindet duke u trajtuar në Qendrën e

Shëndetit Mendor në Gjilan, sipas vendimit të kësaj gjykate me numër P.nr.101/2019 dhe se i njejti është i rregullt në trajtim, me çrast pas deklarimit të eksperti dhe leximit të propozimit të lartcekur nga ana e prokurores, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi propozimin e paraqitur ndaj tij dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë, duke deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen veprës penale e cila i vihen në barrë, pranim i fajësisë ky e cili nuk është kundërshtuar nga palët prezente, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve me aktvendim procedural ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i pandehuri në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, mbetet në tërësi pranë propozimit të paraqitur nga ana e prokurorisë si dhe rekomandimet të cilat i përmbane njejta.

E dëmtuara E. R., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit që të pandehurit ti shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Mbrojtësja e të pandehurit, avokatja Zanita Leka Qerimi, në fjalën përfundimtare deklaroi se pasi që është konstatuar nga eksperti përkatës se i pandehuri nuk është në gjendje të mirë shëndetësore konsideron se propozimi i prokurorisë është adekuat duke propozuar që të njejtit ti vazhdohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

I pandehuri S. R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e mbrojtjes së tij duke shtuar se premtom që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as vepra tjera penale dhe në raport me familjen e tij, i njejti do ti ndryshoj sjellje e tij përkatësisht nuk do të bëjë probleme.

2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe atë prokurores së shtetit, ekspertit të neuropsikistrit Dr. Afrim Canaj, të dëmtuarës E. R., mbrojtëses së të pandehurës avokates Zanita Leka-Qerimi dhe të pandehurit S. R., ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale e cila i vihet në marrë në bazë të propozimit të paraqitur nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e saj, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban propozimi dhe se propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri S.i R., ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata konform nenit 88, nenit 89 dhe 90 të KPRK-së dhe nenit 514 të KPP-së saktësisht dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, ndërsa me rastin e vendimit lidhur me shqiptimin e masës ka marrë parasysh mendimin e ekspertit psikiatër dr.Afrim Canaj, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor si dhe provat e tjera që gjinden në shkresat e lëndës, me çrast konfor nenit 90 paragrafi 1 nën paragrafët : 1.1; 1,2 dhe 1.3 të KPRK-së, ka konstatuar se për të pandehurin: a) Ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryej prapë vepra të ngjashme penale, b) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për t'iu shmangur kryerjes së veprave penale të tjera, dhe c) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz mirëpo pas njoftimit nga ana e ekspertit psikiatër Dr.Afrim Canaj, se i pandehuri tanimë është duke u trajtuar në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjilan, sipas vendimit të kësaj gjykate me numër P.nr.101/2019, por edhe sipas detyrës zyrtare ka konstatuar i pandehuri i lartcekur me të vërtetë është duke vijuar trajtimin në qendrën e lartcekur sipas aktvendimit të kësaj gjykate me numër P.nr.101/2019, të datës 04.02.2019 dhe se me qenëse të pandehurit S. R., sipas aktvendimit të lartcekur i është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, gjykata konsideroi se nuk mund të urdhëroi që njëkohësisht të zbatohet edhe masa e shqiptuar sipas këtij akvendimi, duke e pezulluar të njëjtën me konstatimin se i pandehuri në fjalë duhet të i përmbahet, gjegjësisht të trajtohet sipas masës së shqiptuar më parë.

5.Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke pasur parasysh se e dëmtuara E. R., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e njëjta nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike, gjykata nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi,

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.140/2019, më datë 17.04.2019

Procesmbajtësja,
Berna Maliqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij akgyrkimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.